

URDHËR
Nr. 10, datë 19.1.2022

PËR DELEGIM KOMPETENCASH

Në mbështetje të pikës 2, të nenit 28 dhe nenit 29, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar; të germës “b” dhe “ç”, të nenit 13, dhe germës “a”, të nenit 21, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, si dhe të germës “a”, të pikës 1, të nenit 7, dhe germës “a”, të pikës 1, të nenit 30, të rregullores “Për veprimtarinë e Kolegjit të Posaçëm të Apelit të Gjykatës Kushtetuese”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave të titullarit të Kolegjit të Posaçëm të Apelit të znj. Laerta Rooze, me detyrë Sekretar i Përgjithshëm i Kolegjit të Posaçëm të Apelit, për të kryer procedurat dhe nënshkruar aktet në emër të Kolegjit të Posaçëm të Apelit, për marrjen me qira të ambienteve për nevoja të Kolegjit të Posaçëm të Apelit, sipas parashikimeve në legjislacionin në fuqi.
 2. Znj. Laerta Rooze nuk mund t’i nëndelegojë këto kompetenca.
 3. Delegimi i kompetencave mbaron me shfuqizimin e aktit të delegimit.
 4. Për ndjekjen dhe zbatimin e këtij urdhri ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm i Kolegjit të Posaçëm të Apelit.
- Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Albana Shtylla